



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 77/2012
Prishtinë, më 25.09.2012, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha-Shala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Visar Ymeri, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Berat Buzhala dhe Ramiz Kelmendi.

Pjesëmarrës të tjerë: Burim Ejupi- INDEP; Nevahir Haziri – KDI dhe Erëza Pula-GLPS.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi, Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të mbajtura më 18 dhe 20.09.2012;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 04/L-154 për punimet nga metalet e çmuara;
4. Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente për Projektligjin Nr. 04/L-136 për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme;
5. Të ndryshme;

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të mbajtura më 18 dhe 20.09.2012

Procesverbali nga mbledhjet e mbajtura të datës 18 dhe 20.09.2012 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 04/L-154 për punimet nga metalet e çmuara

Kryetari - Hapi debat në parim në lidhje me këtë projektligj të proceduar nga Qeveria dhe propozoi që të formohet një grup i punës. Ashtu siç është e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, që ky grup i punës ta shqyrtojë Projektligjin, Nr. 04/L-154 për punimet nga metalet e çmuara dhe pastaj që t'i nxjerrin Propozim-amendamentet për shqyrtim në mbledhje të Komisionit.

Pas debatit, Komisioni unanimisht nxori këtë

P ë r f u n d i m

Miratohet në parim Projektligji Nr. 04/L-154 për punimet nga metalet e çmuara.

Kuvendit vendosi që t'ia paraqet këtë

R e k o m a n d i m

Të miratohet në parim Projektligj Nr. 04/L-154 për punimet nga metalet e çmuara.

Po ashtu, Komisioni unanimisht nxori këtë

V E N D I M

- 1. Formohet grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit Nr. 04/L-154 për punimet nga metalet e çmuara.*
- 2. Grupi i punës ka këtë përbërje: Teuta Sahatqija raportuese, Sala Berisha- Shala dhe Visar Ymeri - anëtarë.*
- 3. Secili anëtar i Komisionit, sipas interesimit, mund t'i bashkëngjitet grupit të punës gjatë punës së tij.*
- 4. Grupi i punës, në bashkëpunim me Njësinë koordinuese të Komisionit, të hartojë Planin e Veprimit dhe pastaj të përgatisë raport me shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.*

4. Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente për Projektligjin Nr. 04/L-136 për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme

Kryetari – Tha se për këtë projektligj është organizuar dëgjim publik dhe grupi punues ka mbajtur disa takime më bashkëpunim më përfaqësuesit Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë-

MTI-së. Më pas, fjalën ia dha kryesueses së Grupit të punës, znj. Teuta Sahatqija për të paraqitur Propozim-amendamentet.

Teuta Sahatqija – Tha se grupi punues ka realizuar dy takime dhe ka shqyrtuar me vëmendje Projektligjin, në të cilin gjatë gjithë kohës ka marrë pjesë MTI, si sponsorizues me drejtoritë përkatëse dhe njëherit kemi organizuar dëgjim publik dhe kemi marrë shkresa nga palët e interesit. Pastaj prezantoi para Komisionit Propozim-amendamentet, 32 sosh dhe e arsyetoi secilin veç e veç.

Visar Ymeri – Kërkoi sqarime në lidhje me **amendamentet 3 dhe 5**, respektivisht në lidhje me përkufizimet e “pengut” dhe “sendit të luajtshëm”.

Teuta Sahatqija – Tha se këto dy përkufizime i kemi hartuar duke u bazuar kryekëput nga ligji në fuqi për pronësi dhe të drejtat sendore.

Sala Berisha – Shala – Kërkoi sqarime në lidhje me **amendamentin 8**, që ka fshirë fjalën “vulosur”.

Teuta Sahatqija – Tha se arsyeja është për shkak se është dokument elektronik dhe nuk është e nevojshme të kemi vulosjen e dokumentit.

Lutfi Zharku – Sqaroi se kemi të bëjmë me certifikatë të regjistrimit dhe ky dokument është tërësisht elektronik dhe i lëshuar në formë elektronike, andaj si i tillë e kemi pa të arsyeshme që të fshihet fjala “vulosur”.

Visar Ymeri – Kërkoi sqarime në lidhje me **amendamentin 14** dhe propozoi që të riformulohet amendamenti, ku thuhet Ministria të lidhë marrëveshje mirëkuptimi me institucionet publike, ndërsa me autoritetet financiare të lihet optionale. Pra ta bëjmë të detyrueshme me institucione publike, ndërsa me institucione të tjera në këtë rast ato financiare të vendoset lidhëza “mund”.

Teuta Sahatqija – Tha se arsyeja është për shkak se autoritetet publike janë të detyrime të veprojë në bazë të kërkesave, ndërsa me institucione të tjera mund të lidhet nëse e sheh të arsyeshme.

Lutfi Zharku – Sqaroi se ministria mund të lidhë marrëveshje për detaje, si mirëmbajtja, shpërndarja e zakonshme e të dhënave në SRP, ndërsa për informata të tjera mund të japë në çdo kohë, andaj e kemi lënë si option këtë propozim.

Sala Berisha – Shala – Propozoj që të kemi një formulim si vijon: Ministria mund të lidhë marrëveshje mirëkuptimi me institucionet financiare për mbledhje, mirëmbajtje, shpërndarje të zakonshme të të dhënave dhe informacionit, vetëm siç parashihet në SRP.

Propozimi i deputetes Sala Berisha – Shala u përkrah nga Komisioni.

Visar Ymeri – Tha se në **nenin 24, paragrafi 2** duhet të fshihet fjala “shlyerje” dhe të zëvendësohet me “arkivim”.

Teuta Sahatqija – Tha se nuk kemi nevojë, sepse ekzistojnë back-up që mbesin automatikisht edhe pse shlyhet regjistrimi ajo mbetet çdo herë. Po ashtu çështjen e arkivimit e kemi të rregulluar me nenin 7 të Projektligjit.

Pas debatit Komisioni unanimitet nxori këtë

Përfundim

- 1. Miratohen amendamentet për Projektligjin Nr. 04/L-136 për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme.*
- 2. Raporti me amendamente i dërgohet komisioneve të përhershme sipas procedurës së rregullt.*

5. Të ndryshme

Çështje vijuese;

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit

Zenun Pajaziti